

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Koestinger & Partners - Innovation Sustainability" Sh.p.k.**

Ne Tirane sot me date 01 Shkurt 2022 (dymije e njezeteedy), une **Znj. Asetila Koestinger**, me atesi Pjeter, e datelindjes 29.01.1977, lindur ne Kruje, dhe banuese ne Austri, 1040 Wien, Graf Starhemberg Gasse 4/8, zoteruese e pasaportes austriake me numer P7195722, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem themelues, hartoj kete Akt Themelimi, ne baze te dispozitave ligjore te Ligjet Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregetare" dhe Ligjet Nr 9723 date 3.5.2007, " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" si me poshte:

**KREU I**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 1**

Emri i shoqërisë me pergjegjësi të kufizuar eshte "**Koestinger & Partners - Innovation Sustainability" Sh.p.k** (që këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria").

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (Akti i themelimit dhe Statuti i shoqerise). Shoqeria eshte person juridik. Ajo e fiton kete te drejte si person juridik nga data e regjistrimit te kesaj shoqerie ne QKB.

Kjo shoqeri do ta kete seline e saj ne adresen: Rr. Mine Peza, Nd.81, H.4, Ap.2, Njesia Bashkiake nr.10, Tirane.

**NENI 2**

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje kohezgjatje pa afat. Kjo shoqeri mund te zgjase afatin e saj te veprimtarise ose mund te mbylle aktivitetin e saj edhe para mbarimit te ketij afati, e realizuar kjo sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut, me vendim te Ortakut te vetem dhe sipas kritereve qe percaktohen ne legjislacionin ne fuqi.

**NENI 3**

Shoqeria per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet pergjigjet vetem me pasurite e saj. Ortaku i vetem i kesaj shoqerie nuk perggjigjet per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurite e tyre qe nuk jane futur ne kapitalin e kesaj shoqerie. Pjesemarrja ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

## KREU II

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

#### NENI 4

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e:

Te ofroje sherbime te konsulences, per bizneset, SME-të, Start-ups dhe klientet, dhe te zbatoje projekte zhvillimore per donatoret nderkombetare, institucionet qeveritare brenda dhe jashte Shqiperise. Sherbimet e Kopmanise perfshijne asistence teknike per bizneset dhe institucionet qe kerkojne rritje, ne fushen e eksportit, inovacionit, dhe qëndrueshmërise qëndrueshmëri ekonomike dhe ambientale si dhe ekspertize ne lidhje me zhvillimin e aktiviteteve dhe permiresimin e performances se tyre ekonomike perfshire zgjidhje teknike për biznesin në zhvillimin, gjetjen dhe aksesin drejt tregjeve te reja, dhe optimizimin e operacioneve te tyre. Kompania gjithashtu do te ofrojne koncepte dhe zgjidhje dixhitale, perfshire sherbime te asistencës teknike dhe operacionale mbi monitorimin dhe vlerësimin e programeve zhvilluese, zbatimin e projekteve më qëllim zhvillimin e supermarrjeve dhe eksportit, projekte zhvillimi dhe kërkimore në fushën turizmit, incentivimin e ekonomisë, punësimimin e të rinjve, sherbimeve te tregtise, dhe sherbimeve te konsulences ne sektorin e konkurrueshmërine se biznesit dhe inovacione sociale në zonat rurale dhe urbane. Kompania harton dhe zbaton Programe dhe Projekte në fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve, planifikim projekt i buxhetimi, hartimin dhe zbatimin e proceseve të vlerësimit, projekte partneriteti me shtetet fshqinje dhe rritjen e kapaciteteve te njohurive mbi zhvillimin dhe zbatimin e projekteve. Gjithashtu shoqeria do te kryeje dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar nga legjislacioni apo aktivitete ndihmese te veprimtarive si me siper.

## KREU III

### KAPITALI THEMELTAR

#### NENI 5

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie perbehet ne para me nje vlere prej 10.000 Leke (dhjete mijë), i perbere nga 1 kuote që përfaqëson 100% të kapitalit fillestar të Shoqërisë dhe eshte krejtesisht i derdhur ne te holla.

Ky kapital themeltar zoterohet nga ortaku i vetem i kesaj shoqerie.

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme nga ortaku i vetem i kesaj shoqerie tek te tretet.

Te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar ne natyre behen me miratimin e ortakut. Vleresimi i ketij kapitali behet nga ortaku i shoqerise dhe me vendim te Ortakut te Vetem dhe nga nje ekspert kontabel i caktuar nga vete Ortaku i Vetem.

#### NENI 6

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie perbehet ne para me nje vlere prej 10.000 Leke (dhjete mijë), i perbere nga 1 kuote që përfaqëson 100% të kapitalit fillestar të Shoqërisë .

Zmadhimi ose zvogelimi i ketij kapitali vendoset nga ortaku i vetem. Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim te Ortakut te vetem i cili do te percaktoje formalitete per pranimin e pjesemarresve te rinj. Per çdo pjesemarres te ri qe do te pranohet, shoqeria jep nga nje vertetim per numurin e kuotave qe zoteron dhe vleren e tyre. Ne rastin kur kuotat e kapitalit te shoqerise transferohen ne favor te nje personi te trete, ai merr automatikisht te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka Ortaku qe dorezon kuotat, pra qe

largohet, perfshi edhe ato lloj detyrimesh qe Ortaku shites ka marre mbi vehte duke firmosur kontraten per themelimin e shoqerise.

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne baze te nje pavaresie te plete ekonomike. Ajo nuk pranon asnje nderhyrje nga organet shteterore apo publike te çfaredo lloji, perjashtuar kontrollit qe ka te drejte te bejne organet shteterore kompetente ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi.

## KREU IV

### ORGANET E SHOQERISE

#### NENI 7

Organet e shoqerise janë:

- 1- Asambleja e Ortakut të Shoqërisë
- 2- Administratori

## KREU V

### ADMINISTRIMI

#### NENI 8

**Administrator i Pergjithshem i shoqerise do te jete Znj. Asetila Koestinger**, e cila kryen veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise, ose me prokure te pergjithshme me ane te se ciles i delegon kompetencat ndonje personi te trete.

**Afati i administrimit te shoqerise nga Administratori do te jete deri ne 3 (tre) vjet.**

Ne marredheniet me te tretet Administratori ka te gjithe kompetencat per te kryer veprimet ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe qe jane te perputhje me objektin e shoqerise. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete kur gjate veprimeve te tyre shkelet ligji, akti i themelimit dhe statuti i shoqerise ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

#### NENI 9 REGJISTRIMI

Fillimin e aktivitetit te saj tregetar kjo shoqeri e lidh me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Per sa nuk eshte folur shprehimisht ne Aktin e Themelimit do te pasqyrohet hollesisht ne dispozitat e Statutit.

### SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Koestinger & Partners - Innovation Sustainability" Sh.p.k.

ORTAKU I VETEM  
Znj. Asetila Koestinger  
Asetila Koestinger  
3